



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 79 Akti

Nr. 112 Vendimi
Tiranë, më 04.03.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Relator
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, më datë 18 shkurt 2019, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Dritan Peka, me detyrë prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Peka, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 18.02.2019 kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- a- Z. Dritan Peka, për shkak të funksionit të tij si prokuror, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹;
- b- Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues, pasi administroi dhe studioi tre raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 30.01.2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, komisioneri Roland Ilia. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit;
- c- Pasi ishte konsideruar e përfunduar veprimtaria verifikuese, më datë 01 shkurt 2019, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën hetimore, dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për z. Dritan Peka, të bazohej në të tri kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016;
- d- Më datë 04.02.2019, Komisioni, njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht dhe anekset relative; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016,

¹ Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: “*Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio*”.

- për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 14 shkurt 2019; (iii) për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative;
- e- Më datë 14.02.2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e tij, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, mbi rezultatet e hetimit kryesisht;
 - f- Po, më datë 14 shkurt 2019, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 5 vendosi të ftoj, – përmes postës elektronike, – subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 18 shkurt 2019. Datë në të cilën u zhvillua rregullisht seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Peka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/201, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova. Në fillim të seancës dëgjimore, të datës 18 shkurt 2019, pasi u verifikua prezenca e subjektit të rivlerësimit së bashku me përfaqësuesin e tij ligjor si dhe prezenca e vëzhguesit ndërkombëtar, përpara sesa të merrte fjalën relatori, nga ana e kryesuesit të seancës u kryen njoftimet e nevojshme për publikun dhe mediat prezent/e.
- ii. Më pas, e mori fjalën relatori i çështjes, i cili paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë hetimeve të kryera mbi të tri kriteret e rivlerësimit, ku nëpërmjet shqyrtimit, edhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, ishte konkluduar në rezultate mbi të tri kriteret.
- iii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, z. Dritan Peka, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse të detajuara lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.
- iv. Gjithashtu, në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion, ai kërkoi konfirmimin e tij në detyrë;
- v. Seanca dëgjimore e datës 18 shkurt 2019 u ndërpre, dhe u caktua data 21 shkurt 2019 për shpalljen e vendimit.
- vi. Trupi gjykues, gjatë procesit të vendimmarrjes konstatoi nevojën për të pasur më shumë kohë në dispozicion, për të mundësuar studimin e detajuar të të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.
- vii. Për sa më trupi gjykues vendosi të shtynte datën e seancës për shpalljen e vendimit, më datë 04 mars 2019, duke kryer njoftimet përkatëse.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI; c) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; e) opinionin e paraqitur nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit pranë Komisionit, - në bazë të nenit “B” të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; f) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; g) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore - për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; h) deklaratimet e personave të tjerë të dëgjuar; i) faktet e njohura botërisht.

A - Procesi i rivlerësimit për kriterin e pasurisë

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka dërguar, me shkresën nr. 380/34, në datën 16.11.2017, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Peka, ku konstatohet se:

- *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *Ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *Subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës

së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

- viii. Apartament banimi në pronësi të subjektit dhe të bashkëshortes, me sip. 94.6 m², ndodhur në, Rr. “****”, Tiranë;
- ix. Apartament banimi, me sip. 59.49 m², ndodhur në ***, Vlorë;
- x. Automjet, tip “BMW 523 I”, viti 2008.

1. Apartament banimi në pronësi të subjektit dhe të bashkëshortes, me sip. 94.6 m², ndodhur në, Rr. “**”, Tiranë.**

- i. Kjo pronë është blerë me kontratë shitje, më datë 24.05.2012, me çmim prej 49.440 USD;
- ii. Lidhur me kryerjen e pagesave të çmimit të kësaj pasurie, rezultojnë se palët janë likuiduar tërësisht jashtë zyrën noteriale, përpara datës 14.06.2010, pasi pikërisht në këtë datë, Banka K.G. - datë 23.05.2003, kishte dhënë një kredi për pagesën e këtij apartamenti, - ka lëshuar deklaratë noteriale nr. 2384/969, për çregjistrimin e bllokimit të bërë për pasurinë e paluajtshme nr. ***, ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, në bazë të kontratës për sigurimin e ripagimit të kredisë në shumën prej 28.000 eurosh;
- iii. Kjo shumë (prej 28.000 eurosh) rezultojnë të jetë paguar nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë personale të administratorit të shoqërisë shitëse, më datë 04.06.2003;
- iv. Mandatet e pagesave të shoqërisë shitëse - të paraqitur nga subjekti, - kanë data të ndryshme nga ajo e transfertës efektive;

1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit:

- v. *Subjekti ka pohuar se mandatpagesat e mësipërme i ka marrë nga shoqëria ndërtuese dhe për atë nuk kishte rëndësi data e tyre por fakti që ato provonin kryerjen e pagesës për shumën në fjalë;*
- vi. *Gjithashtu, subjekti sqaroi se mospërputhja e datave është një lapsus i personit që i ka plotësuar ato (ekonomisti i shoqërisë ndërtuese), i cili me sa duket i është referuar kontratës së kredimarrjes dhe jo asaj së kryerjes së transfertës;*
- vii. *Pra për subjektin e rivlerësimit kishte rëndësi dokumentimi i faktit që ishte paguar vlera e apartamentit në fjalë, dhe jo data e saktë e kryerjes së pagesës².*

1.2 Arsytimi ligjor në lidhje me faktet

- viii. Komisioni ka konstatuar se shumën prej 28.000 eurosh, e marrë nëpërmjet kredisë së sipërcituar ka kaluar direkt nga banka në llogarinë e administratorit të shoqërisë shitëse, më datë 04.06.2003, dhe se kredia në fjalë së bashku me interesat e parashikuara, janë paguar rregullisht, deri në shlyerjen totale që është bërë, më datë 14.06.2010;

² Pra, subjekti e pranon mospërputhjen por e konsideron atë një gabim material të personit që i ka plotësuar mandatet.

- ix. Për këtë apartament, rezultoi e paguar e gjithë shuma e parashikuar, pa u konstatuar mungesa të burimit financiar, dhe më datë 30.05.2012, ZVRPP-ja Tiranë ka lëshuar certifikatën e pasurisë, në emër të subjektit dhe të bashkëshortes së subjektit;
- x. Lidhur me mospërputhjet e datave të mandatarkëtimit të sipërpërmendur me datën e pagesës efektive të kryer, trupi gjykues, vlerëson se duke qenë një dokument i prodhuar nga një person i tretë, ato duhet të konsiderohen pasaktësi që janë kryer nga redaktuesi/plotësuesi/nënshkruesi i dokumentit, dhe nuk mund të konsiderohen si një burim përgjegjësie direkt për subjektin, për më tepër që prova e marrë nga dokumentacioni bankar mjafton dhe prevalon mbi mandatpagesat, duke i bërë këta të fundit jo të rëndësishëm në lidhje me vërtetimin e kryerjes së kësaj pagese.

2. Apartament banimi, me sip. 59.49 m², ndodhur në, *, Vlorë.**

- i. Kjo pasuri është blerë me kontratën e shitblerjes, më datë 17.12.2011, me çmim 20.000 euro. Burimi është deklaruar me kredi dhe me të ardhurat nga paga;
- ii. Për këtë pasuri është konstatuar, gjithashtu, se më parë ishte lidhur edhe një kontratë sipërmarrjeje, nr. ***, më datë 23.12.2010, nga ku rezulton se çmimi prej 20.000 eurosh, ishte deklaruar i paguar paraprakisht dhe plotësisht para datës së nënshkrimit të kontratës³ në fjalë;
- iii. Më datë 15.3.2012, ZVRPP-ja Vlorë ka lëshuar certifikatën e pasurisë në fjalë, nr. ***, në emër të subjektit dhe bashkëshortes së subjektit;
- iv. Për blerjen e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar si burim dhe ka paraqitur kontratën e kredisë bankare pranë “BKT”-së, me nr. ***, më datë 08.07.2010. Vlera e kredisë bankare ka qenë 5.000.000 lekë;
- v. Marrja e kësaj kredie nga subjekti, është bërë në kuadrin dispozitave të VKM-së, nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore”. Gjithashtu, baza ligjore për marrjen e kredisë është edhe udhëzimi nr. 6257, datë 02.09.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi nga shteti”, si dhe udhëzimit nr. 10240/1, datë 17.10.2008;
- vi. Sipas aneksit të kësaj kontrate, shuma e kredisë prej 5.000.000 lekësh do të përdorej për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të apartamentit të porositur në Tiranë dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë direkt në llogarinë e shitësit të objektit të kredituar shoqërisë “***” sh.p.k., me transfertë bankare nëpërmjet “BKT”-së;
- vii. Për marrjen e kredisë është vendosur edhe një kontratë hipotekimi me nr. ***, më datë 08.07.2010, në favor të “BKT”-së, pasuria apartament, me nr. ***, pall. *** shk. ***, k. ***, ap. ***, ndodhur në, Rr. “****”, Tiranë;
- viii. Me shkresën nr. ***, datë 21.2.2018, “BKT”-ja ka dërguar informacion lidhur me të dhënat dhe veprimet bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur. Nga studimi i dokumentacionit në fjalë ka rezultuar se:

³ Kontratë shitblerje, datë 17.12.2011.

- a. *Bashkëshortja e subjektit i ka bërë kërkesë Kryeministrit në vitin 2010, për t'u trajtuar me strehim sipas pikës 1/e të VKM-së, nr. 600, datë 12.09.2007, "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civil të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë", të ndryshuar;*
- b. *Ndër të tjera, sipas pikës 6 të VKM-së së sipërcituar: "Subjekteve, të përcaktuara në pikat 1 e 5 të këtij vendimi, u lind e drejta për strehim apo për sipërfaqe shtesë banimi, kur: a) në vendin e ushtrimit të detyrës nuk kanë në pronësi të tyre, bashkëshortit/es apo të çdo pasardhësi, paraardhësi a personi tjetër në ngarkim, pasuri të paluajtshme për strehim, me sipërfaqe banimi, sipas kuotave të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi; b) nuk kanë në pronësi të tyre, bashkëshortit/es apo të çdo pasardhësi, paraardhësi a personi tjetër në ngarkim, pasuri të paluajtshme, që përdoret për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi; c) ata, bashkëshorti/ja nuk janë pjesëtarë në veprimtari tregtare, sipas ligjit për shoqëritë tregtare, apo nuk përfitojnë të ardhura nga veprimtari ekonomike a veprimtari të tjera fitimprurëse profesionale, përfshi edhe mësimdhënien; ç) nuk kanë në pronësi të tyre apo bashkëshortit/es pasuri të luajtshme, mjete motorike për qarkullim në tokë/det/ajër, likuiditete, tituj pronësie, përfshi edhe të drejtat reale pasurore, me vlerë më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim";*
- c. *Në kohën e paraqitjes së kërkesës dhe marrjes së kredisë së butë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij rezultojnë të kishin të drejta reale mbi dy pasuri të paluajtshme: njëra në bashkëpronësi me prindërit (pasuria nr. ***, në adresën, Rr. "****", pall. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë) dhe një tjetër pasuri në bashkëposedim bashkëshortor (lidhur kontratë porosie, më datë 05.12.2002, me shoqërinë "****" sh.p.k., ku për këtë pasuri ishte likuiduar vlera e plotë për blerjen e saj, prej datës 14.06.2010);*
- d. *Më datë 14 korrik 2010 bashkëshortes së subjektit i kanë kaluar në llogari bankare shumën prej 5.000.000 lekësh. Po në të njëjtën datë, shuma prej 5.000.000 lekësh, ka kaluar nga llogaria e bashkëshortes së subjektit te shoqëria "****" sh.p.k.;*
- e. *Më parë, më datë 14.06.2010, subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshorten, kishin lidhur një kontratë porosie⁴ me shoqërinë "****" sh.p.k., për blerjen e një apartamenti banimi 2+1, të ndodhur në, Rr. "****", Tiranë, me vlerë 55.000 euro.*

2.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit:

Sipas deklarimeve, përgjigjeve dhe shpjegimeve të tij, rezultojnë se subjekti ka pohuar sa vijon:

- ix. *Ka lidhur kontratë porosie për një apartament me shoqërinë "****" sh.p.k., datë 14.06.2010, tek noteri dhe pagesat për këtë blerje do të kryheshin nëpërmjet kredisë që do të merrte bashkëshortja e subjektit;*
- x. *Për këtë shkak ishte paraqitur kërkesa për një kredi sipas VKM-së, nr. 600, datë 12.09.2007, dhe dokumentacioni i kërkuar pranë Kryeministrit (në institucionin ku punonte bashkëshortja e subjektit);*
- xi. *Pasi ky institucion kishte vlerësuar dhe verifikuar plotësimin e kriterëve të kërkuara nga legjislacioni në fuqi, kishte aprovuar/akorduar dhënien e kredisë së butë;*

⁴ Kontrata nr. ***.

- xii. Më pas, procedura ishte ndjekur nga banka e cila kishte vendosur për dhënien e kredisë në fjalë, duke kaluar të gjithë shumën prej 5 milion lekësh në llogarinë e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k. Ndërsa shumën prej 15.000 eurosh, që e kishte paguar më parë – ishte hua nga E.T., dhe iu kthye mbrapsht, brenda atij viti, pasi u revokua kontrata me shoqërinë, dhe për këtë arsye ajo nuk duhej të deklarohet⁵;
- xiii. Në muajt në vijim - pas marrjes së kredisë – pasi ishin konstatuar problematika lidhur me cilësinë e punimeve dhe të planimetrisë së apartamentit të porositur, subjekti dhe bashkëshortja nuk ishin më të interesuar për ta blerë apartamentin në ato kushte;
- xiv. Më vonë, kontrata e lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. është prishur/revokuar me marrëveshje ndërmjet palëve dhe pala shitëse i ka kthyer mbrapsht shumat e marra nga subjekti dhe nga bashkëshortja e tij;
- xv. Pas kthimit të këtyre parave – duke qenë se nuk ishte parashikuar mundësia e kthimit pas tek banka, shumat e marrë kredi, me një pjesë të tyre është paguar shuma prej 20.000 eurosh në favor të shoqërisë “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit, me sip. 64.85 m², nr. ***. pll. ***, ***, Vlorë, - për të cilën rezulton çmimi i likuiduar përpara nënshkrimit të kontratës së porosisë lidhur tek noteri;
- xvi. Lidhur me plotësimin e kriterëve për marrjen e kredisë së butë, subjekti insiston se bashkëshortja e tij i plotësonte të gjitha kriteret, pasi ata nuk kishin asnjë pronësi të regjistruar në emër të tyre, me përjashtim të pjesës takuese, me sip. 17 m², ndodhur në, Rr. “****”, në bashkëpronësi me familjarët e subjektit;
- xvii. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se lidhur me apartamentin e porositur në Rr. “****”, Tiranë, ai dhe bashkëshortja nuk kishin ende pronësinë dhe veç të tjerash ata kishin edhe një pasiguri nëse do të konkludohej apo jo kjo blerje, pasi shoqëria ndërtuese ishte në procese gjyqësore shumëvjeçare me pronarët e tokës;

2.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet

- xviii. Nga njëra anë kredia e butë, e marrë nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, ishte e dyshimtë nëse ajo ishte realizuar apo jo, në shkelje të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga VKM-ja, nr. 600/2007, pasi nuk bëhej fjalë për një familje të pastrehë, në kuptimin e kësaj dispozite (duke pasur parasysh faktin që familja e trajtuar si e pa strehë, nga momenti që posedonte në qytetin e Tiranës, një apartament, me sip. 94,6 m², ndodhur në, Rr. “****” si dhe pjesën takuese prej 1/4 e një tjetër apartamenti të ndodhur në, Rr. “****”);
- xix. Por, nga ana tjetër, duhet konsideruar edhe sa vijon:
 - a - Kërkesa për kredi të butë është vlerësuar dhe aprovuar nga dy institucione – Kryeministria dhe “BKT”-ja – të cilat kishin kompetencën dhe detyrimin që të verifikonin plotësimin ose jo të kriterëve të parashikuara nga VKM-ja, nr. 600/2007, nga ana e kërkuarëve, përpara sesa të kalonin kredinë në favor të tyre;

⁵ Subjekti ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me këtë shumë, gjithsesi Komisioni e konsideron si një rrethanë jo përcaktuese, nga momenti që ajo është kthyer mbrapsht brenda të njëjtit vit, pra pa prodhuar efekte në bilancin vjetor, apo në investimet e kryera nga subjekti.

b - Fakti i mospasjes së një pronësie nga ana e subjektit⁶ dhe e bashkëshortes së tij - që mund të ishte pengesë për dhënien e kredisë së butë në favor të tyre - rezultoi i provuar;

c - Dyshimi qëndron mbi interpretimin e pikës 6, shkronja “ç” të VKM-së, nr. 600/2007, nëse togfjalëshi “... të drejta reale pasurore ...” i referohet të drejtave që rrjedhin nga titulli i pronësisë apo edhe “posedimit”, pasi në rastin konkret bashkëshortët kishin një apartament në posedim⁷, por ende jo në pronësinë e tyre. Në mungesë të një interpretimi të njëzëshëm, trupi gjykues çmon se thjesht dyshimi nuk mund të penalizojë subjektin;

d - Ka qenë bashkëshortja e subjektit që ka aplikuar për kredi të butë, në sajë të “statusit të nëpunësit civil” që ajo kishte prej vitesh⁸, dhe për rrjedhojë jo automatikisht mund të penalizohet subjekti edhe nëse mund të jetë kryer një interpretim i gabuar ligjor nga ana institucioneve kompetente⁹ apo nga bashkëshortja e subjektit.

Shuma e marrë nëpërmjet kredisë së butë, në vlerën prej 5.000.000 lekësh, fillimisht është përdorur për qëllimin e paracaktuar në kontratën e kredisë në fjalë, - pra për blerjen e apartamentit (nga shoqëria “****” sh.p.k.), në Tiranë, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen e bërë me “BKT”-në;

- xx. Pas revokimit të kontratës së porosisë me shoqërinë “****” sh.p.k., - në mungesë të një dispozite shtrënguese për të kthyer pas shumën e marrë nga kredia, bashkëshortët kanë vendosur përdorimin e pjesëshëm të saj për blerjen e një tjetër apartamenti dhe pjesën tjetër për arredim. Edhe këtu mund të ketë fushë interpretimi lidhur me mundësinë e kthimit pas të shumës, tek banka që kishte dhënë kredinë, por mungon një parashikim detyrues në këtë drejtim;
- xxi. Për rrjedhojë, trupi gjykues, - përtej dyshimeve dhe interpretimeve të ndryshme, - çmon se nuk ka prova të mjaftueshme për të konkluduar se nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortes së tij, ka pasur një përfitimin të kredisë së butë, në kundërshtim të qartë me dispozitat normative në fuqi apo ndonjë fiktivitet kontraktor i kryer prej tyre;
- xxii. Së fundmi, lidhur me këtë pikë, Komisioni, çmon se edhe në rast të një interpretimi më të gjerë të togfjalëshit “... të drejta reale pasurore ...” të pikës 6, shkronja “ç”, të VKM-së, nr. 600/2007, - ku të përfshihej edhe “e drejta e posedimit” - në sajë të argumenteve të mësipërme,- dhe duke konsideruar edhe faktin që në këtë procedurë janë përfshirë edhe aktorë, kontrollues dhe autorizues të ndryshëm, kjo kredi nuk duket se do të gjeneronte një përgjegjësi të drejtpërdrejtë të subjektit të rivlerësimit, dhe gjithsesi ajo nuk mund të përbënte, në vetvete, një shkak të mjaftueshëm për aplikimin e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në rastin konkret.

⁶ Në kuptimin e plotë të pronësisë, pra si pasuri e rregjistruar në emër të tyre, me përjashtim të bashkëpronësisë, me pjesë takuese ¼, të apartamentit në Rr. “****”, Tiranë, ku pjesa takuese përkon me një sip. rreth 17,75 m², dhe për rrjedhojë jo e mjaftueshme për familjen e subjektit, dhe për këtë arsye ajo mund të konsiderohet si një pengesë për marrjen e kredisë së butë. Gjithashtu, ky apartament rezultoi të jetë privatizuar nga prindërit e subjektit, më datë 23.07.1993, pra përpara sesa subjekti të emërohej në detyrën e prokurorit, dhe për rrjedhojë ai nuk paraqet problematika në lidhje burimin e krijimit (kostot e privatizimit).

⁷ I cili konsiston në një rrethanë faktike, të pa transformuar ende në një të drejtë të pronësisë në kuptimin e plotë të saj. Ndryshe do të ishte nëse do të bëhej fjalë për të drejtën e uzufruktit, e cila është e kornizuar nga legjislacioni civil, si një e pjesë e së drejtës së pronësisë (gëzimit të sendit), pa patur pronësinë e sendit, por me të drejtën e përdorimit të tij, pa i ndryshuar destinacionin. Në këtë rast do të mund të konsiderohej më e plotësuar nevoja e një vendbanimi;

⁸ Konform ligjit nr. 8549/1999, neni 30 dhe VKM-ja nr. 600 datë 12.09.2007;

⁹ Kryeministria dhe “BKT”-ja që ka dhënë kredinë e butë.

3. Automjet, tip “BMW 523 I”, viti 2008.

- i. Kjo pasuri është blerë me kontratë shitblerjeje, më datë 02.12.2013¹⁰, me çmim të deklaruar në shumën prej 980.000 lekësh, dhe me burim financiar: kursime nga të ardhurat familjare;
- ii. Lidhur me pagesën e këtij çmimi, palët kanë deklaruar se janë likuiduar mes tyre, jashtë zyrës noteriale, përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes;
- iii. Sipas deklaratës dhe të dhënave doganore rezultojnë se autovetura në fjalë është blerë në vlerën (e konvertuar) prej 1.983.257 lekësh, si dhe është paguar detyrimi doganor në vlerën 396.650 lekë, nga shitësi S. M., më datë 28.11.2013;

3.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- iv. Shitësi i autoveturës, blinte shpesh mjete jashtë vendit dhe i shiste në Shqipëri. Subjekti i kishte kërkuar, z. S. M., që t'i paraqiste ndonjë okazion për blerje autoveture. Në këtë rast ai ishte bërë më dije për këtë okazion, dhe pas kontrollit të autoveturës nëpërmjet një personi të njohur, i ishte paraqitur një preventiv për riparim me pjesë këmbimi të përdorura, dhe më pas kishin rënë dakord për shitblerjen në fjalë;
- v. Lidhur me diferencën e çmimit të blerjes në krahasim me atë të shitjes të subjekti i rivlerësimit, ky i fundit ka shpjeguar se automjeti në fjalë ishte me defekt dhe riparimi i të cilit, me pjesë të reja, shkonte në vlerën mbi 7.500 euro – por atij i kishte kushtuar 277.500¹¹ lekë¹² dhe për rrjedhojë shitësi (z. M.), e shiti mjetin me atë çmim të ulët;
- vi. Gjithashtu, subjekti ka pohuar se nuk bëhej fjalë për një trajtim preferencial dhe që ai nuk kishte pasur çështje gjyqësore ku mund të përfshihej apo të kishte interes shitësi i mjetit – pra nuk mund të kishte pasur ndonjë konflikt interesi;
- vii. Po ashtu edhe z. S. M., - i pyetur nga Komisioni - ka deklaruar se mjeti, në momentin e shitjes tek subjekti, kishte probleme teknike pasi ai ishte blerë edhe nga ana e tij me defekte, dhe gjithashtu ka shtuar se ai ka mundur ta shiste tek subjekti me atë çmim, pasi prej tij kjo autoveturë i kishte kushtuar rreth 1 milion lekë, pra shumë më pak nga çmimi që i rezultonte Komisionit (vlera 14.000 euro), dhe se riparimi i makinës kushtonte rreth 7.500 euro;
- viii. Gjithashtu, ky i fundit ka shtuar se çmimi nuk ishte paguar ende prej tij, pasi dërguesit ishin shokë të tij dhe - siç ishte bërë edhe në raste të tjera - ata i nisnin mjetet drejt Shqipërisë dhe vetëm pasi ai i shiste ato, u kryente atyre pagesën e çmimit të dakordësuar;
- ix. Për sa më lart, shtetasi S. M., ka pohuar se taksat e paguara prej tij do t'i ktheheshin pas, pasi në vendin e origjinës ato rimburoheshin, nga momenti që destinacioni final i automjetit ishte një vend jashtë Komunitetit Evropian.

¹⁰ Më datë 02.12.2013, subjekti i rivlerësimit ka blerë këtë autoveturë me anë të kontratës nr. ***, nga pala shitëse z. S. M., me çmim 980.000 lekë.

¹¹ Subjekti ka pohuar se autovetura me defekt i është treguar/prezantuar atij nga shitësi (shok i vjetër), për herë të parë në datën 29/11/2013, dhe më pas është bërë vlerësimi i kostos së riparimit. Ndërsa më datën 01/12/2013 (pas dy ditësh) ishin kryer të gjitha riparimet me pjesë këmbimi të përdorura, duke i marrë ato nga një tjetër mjet i të njëjtit model/tip i aksidentuar (pëplasar).

¹² Subjekti ka paraqitur faturat e riparimit të autoveturës në fjalë;

3.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet

- x. Komisioni e konsideron të provuar faktin se autovetura e blerë nga subjekti i rivlerësimit ka qenë me defekte, megjithatë, ngelin dyshime mbi kostot efektive që këto riparime mund të ndikonin në uljen e çmimit të autoveturës;
- xi. Nga ana tjetër janë konstatuar mospërputhje midis deklarimeve të shitësit lidhur me çmimin e blerjes, prej tij, të autoveturës në fjalë dhe çmimit që rezultojnë nga dokumentacioni shoqëruar i mjetit¹³;
- xii. Gjithsesi, këto mospërputhje të deklarimeve të shitësit, edhe pse ngrenë dyshime mbi këtë veprim tregtar-juridik, nuk mund të bëjnë totalisht të pabesueshëm versionin e subjektit dhe ta ngarkojnë me përgjegjësi, për sa kohë nuk është provuar fiktiviteti i kontratës me të cilën subjekti ka blerë mjetin në fjalë – gjë që do të mund të arrihej nëse do të vërtetohej që mjeti nuk ka pasur defektet e përshkruara, si në faturat e riparimit, ashtu dhe nga pohimet e shitësit dhe të blerësit;
- xiii. Lidhur me çmimin e blerjes së mjetit në Gjermani, duke pasur parasysh edhe raste të tjera të ngjashme, Komisioni, konsideron të mundshëm faktin që kostoja/çmimi e/i blerjes për shtetasin S. M., të jetë ulur 19%, në sajë të procedurës së rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar, që rezultojnë të aplikohet për automjetet që shiten dhe regjistrohen jashtë Bashkimit Evropian;
- xiv. Pra, nëse nga çmimi fillestar i blerjes (14.000 euro) do të zbritet rimbursimi 19% (2.660 euro) si dhe shifra e shpenzuar për riparimet,¹⁴ si më lart, kostoja i afrohet më shumë çmimit me të cilin kjo autoveturë është blerë nga ana e subjektit;
- xv. Për sa më lart dhe në mungesë të konstatimit të ndonjë konflikti interesash midis subjektit dhe shitësit të autoveturës tip “BMW 523 I”, trupi gjykues - edhe pse ka dyshime mbi shkakun e vërtetë të diferencës së çmimit të këtij mjeti - nuk vëren prezencën e elementeve provues të një trajtimi preferencial apo të fiktivitetit kontraktor, dhe për rrjedhojë çmon se nga hetimi i kryer nuk janë kristalizuar mjaftueshëm prova për të konkluduar për një përgjegjësi të qartë të subjektit të rivlerësimit, lidhur me rrethanat e përshkruara më sipër, që mund të cënonin figurën e magjistratit.

4. Në lidhje me rezultatet e analizës financiare

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni duke rianalizuar të gjitha kundërshtimet e bëra nga subjekti, dhe duke reflektuar vetëm disa nga pretendimet e tij, të cilat janë çuar si të bazuara¹⁵, ka rezultuar se familja e subjektit të rivlerësimit, ka pasur në disa vite një mungesë të burimeve financiare, për të përballuar njëkohësisht investimet dhe shpenzimet e kryera në ato vite dhe realizimin e kursimeve të deklaruara, siç është pasqyruar në tabelën që vijon. Dhe konkretisht:

¹³ Nga ku çmimi i blerjes, në Gjermani, rezultojnë të ketë qenë në shumën 14.000 euro.

¹⁴ Sipas dokumentacionit provues – dhe pa konsideruar diferencën e kostos së riparimeve me pjesë këmbimi origjinale;

¹⁵ Janë zbritur nga shpenzimet disa udhëtime që subjekti ka arritur të provojë mospërballimin e shpenzimeve prej familjes së tij, pasi ato ishin mbuluar nga institucione apo persona të tretë – sipas raporteve të tij dhe dokumentacionit mbështetës, si dhe është zbritur një shumë e konsideruar si gjendje *cash* në vitin 2005, në bazë të përgjigjeve të subjektit, por ajo nuk ishte deklaruar si e tillë në vitin përkatës, pasi ishte tërhequr në fund të vitit pararendës.

Analiza financiare viti 2005

Përshkrimi	Viti 2005
Të ardhura	1.463.441
Të ardhura nga pagat subjekti +B/SH	1.263.441
Të ardhura nga shitja e automjetit me targë ***	200.000
Shpenzime	865.667
Shpenzime jetese	490.842
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal + interes)	374.825
Pasuri	730.751
Apartament me sip. 94.6 m ² shoqëria “****” ¹⁶	172.347
Ndryshim i gjendjes së likuiditetit ¹⁷	558.404
Diferenca (Të ardhura-Shpenzime-Pasuri)	- 132.977

Analiza financiare viti 2006

Përshkrimi	Viti 2006
Të ardhura	1.779.328
Të ardhura nga pagat subjekti +B/SH	1.779.328
Shpenzime	869.726
Shpenzime jetese	490.842
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal + interes)	378.884
Pasuri	1.117.526
Blerë automjet tip “Nissan Micra”, bashkëshortja	150.000
Ndryshim i gjendjes së likuiditetit ¹⁸	967.526
Diferenca (Të ardhura-Shpenzime-Pasuri)	- 207.924

Analiza financiare viti 2009

Përshkrimi	Viti 2009
------------	-----------

¹⁶ Sipas përgjigjes së pyetësorit të ardhur, më datë 12.10.2018, në vitin 2005, subjekti deklaroi se ka paguar vlerën prej 1.740 USD, përkatësisht, më datë 25.05.2005, dhe kjo shumë është konvertuar me kursin e BSH.-së të datës 25.05.2005.

¹⁷ Subjekti ka deklaruar shumën prej 860.000 lekësh kursime *cash* në shtëpi, gjenda e llogarive bankare rrjedhëse në fund të vitit 2005 në “Raiffeisen Bank” është 20.122 lekë për subjektin dhe 38.282 lekë për bashkëshorten e subjektit.

¹⁸ Gjendja e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur me të në fund të vitit 2006 ishte në shumën 1.891.118 lekë (kursimet *cash* të deklaruara një vit më parë + gjendjet e llogarive rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në “Raiffeisen Bank” dhe “Tirana Bank” + llogari, të futura në emër të djalit të subjektit në Bankën Amerikane), ndërsa në fund të vitit 2005 gjendja e likuiditeteve gjendet në analizën e vitit të mëparshëm.

Të ardhura	2.896.981
Të ardhura nga pagat subjekti +B/SH	2.896.981
Shpenzime	1.496.789
Shpenzime jetese	490.842
Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal + interes)	444.922
Shpenzimet për udhëtime ¹⁹	561.025
Pasuri	1.470.879
Ndryshim i gjendjes së likuiditetit ²⁰	1.470.879
Diferenca (Të ardhura-Shpenzime-Pasuri)	- 70.687

Në totalin e tre viteve me bilanc negativ, Komisioni, ka konstatuar se për subjektin e rivlerësimit, z. Dritan Peka, diferenca e pambuluar nga burime financiare të ligjshme, rezulton të jetë në shumën prej **- 411.588** lekësh.

4.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me analizën financiare

Në lidhje me mungesën e burimeve financiare, siç u tha edhe më lart, subjekti i rivlerësimit *ka kundërshtuar një zë lidhur me likuiditetet²¹ e deklaruar në vitin 2005 dhe 2006, metodologjinë dhe veprimet përlllogaritëse të kryera në analizën financiare, pasi, sipas tij, janë konsideruar shpenzime udhëtimesh më të larta sesa ato që familja e tij ka pasur në realitet në vitin 2009;*

4.2 Arsytimi ligjor në lidhje me faktet

- i. Siç u tha edhe më lart, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit, duke i pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse²² në rezultatet financiare të viteve respektivë.
- ii. Për sa i takon një vlerësimi të përgjithshëm në lidhje me problematikat e analizës financiare, trupi gjykues, çmon se këto mangësi të burimeve financiare, - për një total të akumuluar në tre vite (dhe të shpërndara në harkun kohor 6-vjeçar), në shumën prej 411.588 lekësh, nuk janë të mjaftueshme në vetvete që të pasjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi financiar duhet të kryhet jo vetëm nëpërmjet një analize kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

¹⁹ Shpenzime për udhëtime të rezultuara nga sistemi TIMS.

²⁰ Në vitin 2009 subjekti rezultoi të ketë një shtesë të likuiditeteve *cash* në shumën prej 1.470.879 lekësh.

²¹ Pasi në analizën financiare, duke u nisur nga përgjigjet e pyetësorit, ishte përlllogaritur një shumë kursimesh *cash* më e lartë se ajo që subjekti realisht kishte deklaruar si kursime në vitin 2005. Për rrjedhojë u modifikua analiza financiare e rezultateve të hetimit me atë të pasqyruar më lart.

²² Udhëtimet e bashkëshortes për arsye pune në vitin 2009 – si dhe zbritjen e shumës prej 3.000 USD, pasi janë tërhequr në fund të vitit 2004. Për pasojë ulet minusi i bilancit të vitit 2005.

5. Autoveturë, me targë ***

Me shkresën nr. *** prot., datë 08.02.2018, DPSHTRR-ja konfirmon se bashkëshortja e subjektit znj. N. P., ka në pronësi mjetin me targë ***. Rezultoi se ky mjet nuk ishte deklaruar në deklaratën “Vetting”.

5.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me mosdeklarimin e këtij mjeti.

Për këtë parregullsi është pyetur subjekti i cili ka deklaruar se:

*“Në deklaratën për “Vetting” nuk është deklaruar pronësia e automjetit, pasi ai është shitur në vitin 2013 dhe nuk ka qenë më pronë e imja, por janë deklaruar të ardhurat nga shitja e këtij automjeti. Bashkëlidhur, lutemi gjeni një kopje të kontratës së shitjes, me nr. ***, datë 09.08.2013, pranë noteres A. Ç. Pra, blerësi e mban ende automjetin në emrin e bashkëshortes sime në kundërshtim me ligjin”.*

5.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet

Për sa më lart, rezulton në mënyrë të qartë mungesa e përgjegjësisë së subjektit dhe e bashkëshortes së tij për mosdeklarimin e autoveturës në fjalë në deklaratën “Vetting”, pasi ajo nuk ishte më në pronësinë e tyre, prej datës 09.08.2013, nga momenti që mjeti ishte shitur – fakt ky i provuar nga akti noterial. Gjithashtu, nuk mund të konsiderohet si një përgjegjësi e shitësit, mosndryshimi i emrit të pronarit të autoveturës në regjistrin e DPSHTRR-së, pasi kjo është detyrë e blerësit në bashkëpunim me noterin dhe me zyrat kompetente.

6. Depozitë bankare me vlerë 3.000 USD.

Me shkresën nr. *** prot., datë 09.02.2018, “Intesa Sanpaolo Bank” ka dërguar informacion mbi llogaritë bankare të subjektit dhe personave të lidhur. Sipas kësaj shkrese rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pasur në vitin 2003 një depozitë bankare me vlerë 3.000 USD, të tërhequr në fund të vitit 2004, të cilën nuk e ka deklaruar në deklaratën e parë për vitin 2003.

6.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me mos deklarimin e kësaj depozite

Pasi është pyetur, në lidhje me këtë mos deklarim subjekti ka deklaruar se:

“Depozita i përket vitit të parë të deklarimit. Edhe për ne si subjekte deklaruese ishte hera e parë që deklaronim. Ka qenë një llogari e hapur me të ardhurat nga paga dhe ato dytësore, të gjeneruara nga pagesat e bashkëshortes, si pedagoge e jashtme në lëndën e Drejtë Financiare, në Departamentin e së Drejtës Publike, të fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në kohën që është hapur kjo llogari, në 24 shtator 2002, kam qenë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, kur bashkëshortja jetonte me prindërit. Gjithashtu, në vitin 2004, bashkëshortja në kushtet e shtatzënisë e më pas, të lehonisë, nuk ka qenë në kondicione fizike për të më vënë në dijeni për këtë depozitë. Deklaroj në përgjegjësinë time të plotë, se nuk ka qenë asnjëherë qëllim fshehja e të ardhurave, pasi ato janë në bankë, domethënë janë të deklaruara dhe tërësisht të justifikuar nga ana financiare. Pra, ka qenë thjesht një pakujdesi për shkak të kushteve fizike, në

të cilat gjendej bashkëshortja dhe, mungesës së përvojës për mënyrën e plotësimit të deklaratës periodike vjetore”.

6.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet

Trupi gjykues vlerëson se fakti i mosdeklarimit të kësaj shume përbën një mangësi në deklarim, por kjo nuk mund të konsiderohet si një fshehje pasi bëhet fjalë për një depozitë bankare të vitit 2003, - e cila është tërhequr dhe deklaruar më pas, - dhe jo për një shumë të mbajtur *cash*, që nuk mund të evidentohet nëpërmjet një verifikimi të llogarive bankare. Gjithsesi, edhe fakti që bëhet fjalë për deklaratën e parë, të çon në vlerësimin se një harrese apo mosdeklarim, pa pasoja fshehjeje, nuk mund të pasjellë automatikisht një përgjegjësi të tillë, që të na çojnë në aplikimin e një mase për deklaruesin.

B - Procesi i rivlerësimit për Kontrollin e Figurës

- i. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar, “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit*”;
- ii. Ky raport është deklasifikuar²³, më datë 20.07.2018;
- iii. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione që subjekti të ketë pasur ose të ketë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar;
- iv. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk është konstatuar ekzistenca e ndonjë kontakti të papërshtatshëm, me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për sa më lart, Komisioni, konkludon se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.

C - Rivlerësimi i Aftësive Profesionale

C/1 – Vlerësimi i kryer nga Grupi i Punës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Sipas raportit të Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit rezulton se :

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

²³ Vendim nr. ***, datë 20.07.2018.

Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga gjetjet në grupet e burimeve të informacionit për periudhën e vlerësimit 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, rezulton se :

Subjekti Dritan Peka shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi. Ai përdor arsyetim të qartë dhe lidh drejt normën ligjore me zbatimin e saj në rastin konkret. Subjekt i rivlerësimit, prokurori Dritan Peka për periudhën e rivlerësimit ka qenë Prokuror në Prokurorinë e Apelit Tiranë dhe nga muaji Mars i vitit 2015, drejtues i Prokurorisë së Apelit Tiranë.

Referuar vlerësimit të bërë për të në aspektin profesional rezulton se ai ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota.

Ka marrë pjesë në aktivitetet profesionale si për ngritjen e nivelit të tij profesional, ashtu edhe në shkëmbimin e eksperiencave apo përfaqësimin e institucionit, kryesisht brenda vendit.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, qëndrimet e tij në përfaqësimin e organit të akuzës në proceset gjyqësore janë ligjore, të drejta në respektim të zbatimit të ligjit, duke ndikuar për zgjidhje përfundimtare të çështjes në përputhje me legjislacionin procedural penal (shiko gjetjet në çështjet e shortuara me nr. 4 dhe 5)

Niveli i njohurive ligjore manifestohet po kështu edhe nga 7 (shtatë) temat e përgatitura nga subjekti Dritan Peka dhe të dorëzuara së bashku me Formularin e Vetdeklarimit, të përshkruar në pikën 6 të atij Formulari. Në to bëhen parashtrime dhe analiza të detajuara të kuptimit të termit “i mitur” në procesin penal, zhvillimin e procesit penal ndaj të miturit si autor i veprës penale, duke iu referuar normave ligjore që rregullojnë këtë fushë të së drejtës materiale dhe procedurale, dhe trajtimi në mënyrë të admirueshme të lëndës duke u përmbyllur me rekomandime të vlefshme për punën e subjekteve të procedimit penal.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara për Prokurorin Dritan Peka konstatohet lehtësisht mënyra e saktë e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimit të prokurorit në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas ligjit. Gjuha e përdorur është e kuptueshme, metodat e arsyetimit me deduksion apo induksion, janë pjesë përbërëse e akteve të vlerësuara për efekt të procesit të rivlerësimit. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej subjektit të rivlerësimit kanë shtjellim të kuptueshëm. Subjekti organizon aktin në përputhje me standartet e pranuar për aktet përkatëse (shiko gjetjet në të gjitha dosjet e shortuara) dhe tregon kujdes që konkluzionet e tij të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur përgjatë arsyetimeve.

Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit Dritan Peka për periudhën e rivlerësimit përreth një vit e tetë muaj ka qenë në pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë siç është përmendur edhe më lart në këtë raport, e për këtë arsye është spikatur dhe vlerësuar për aftësi shumë të mira drejtuese. Më konkretisht ka rregulluar organizimin dhe mirëfunksionimin e punës së çdo strukture nëpërmjet urdhërave të detajuar, duke mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm ecurinë efektive të hetimeve dhe punë e secilit prokuror. Gjithashtu ka drejtuar punën për vlerësimin e punës së prokurorëve, sipas parashikimeve të rregullores përkatëse. Ka bërë planifikim të saktë të ndarjes së punës te prokurorët e stafit të Prokurorisë së Apelit Tiranë.

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit Dritan Peka për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se

Për vitin 2014 - subjekti Dritan Peka nuk ka qenë subjekt i vlerësimit periodik të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, pasi ai ka qenë në detyrën e prokurorit të Prokurorisë së Apelit dhe se vlerësimet janë bërë vetëm për prokurorët pranë Prokurorive të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe drejtuesve të Prokurorive të Apelit. Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në Formularin e Vetëdeklarimit rezulton se subjektit i janë caktuar gjatë periudhës së punës për vitin 2014, gjithsej ka trajtuar dhe përfunduar 259 (*dyqind e pesëdhjetë e nëntë*) çështje, ku 105 (*njëqind e pesë*) janë çështje themeli dhe 154 (*njëqind e pesëdhjetë e katër*) çështje për masa sigurimi.

Për vitin 2015 - subjekti Dritan Peka është vlerësuar "*shumë mirë*" për aftësitë organizative të treguara prej tij, pasi ka treguar aftësi të larta drejtuese dhe kontrolluese duke bërë një organizim shumë të mirë të punës në Prokurori, duke përballuar ngarkesë pune të konsiderueshme sipas detyrave të përcaktuara për Prokurorinë e Apelit. Ndërsa për vitin 2015, sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në Formularin e Vetëdeklarimit rezulton se subjektit i janë caktuar gjithsej 73 (*shtatëdhjetë e tre*) çështje themeli.

Për vitin 2016 - subjekti Dritan Peka është vlerësuar "*shumë mirë*" mbështetur në treguesit vjetor të punës, pasi ka përballuar ngarkesë pune voluminoze me cilësi dhe shpejtësi. Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në Formularin e Vetëdeklarimit rezulton se subjektit i janë caktuar 95 (*nëntëdhjetë e pesë*) çështje themeli.

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti në Formularin e Vetëdeklarimit rezulton se subjektit i janë caktuar gjatë periudhës së punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016, gjithsej ka trajtuar dhe përfunduar 427 (*katërqind e njëzet e shtatë*) çështje, ku 273 (*dyqind e shtatëdhjetë e tre*) janë çështje themeli dhe 154 (*njëqind e pesëdhjetë e katër*) çështje për masa sigurimi.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Prokurori subjekt rivlerësimi Dritan Peka nuk ka kryer procedura hetimore për periudhën e rivlerësimit por mënyra sesi veprimet hetimore janë analizuar prej tij, për të mbështetur akuzën e ngritur fillimisht është bërë gjithnjë në funksion të vërtetimit të kësaj akuze duke mbështetur akuzën

e ngritur apo kërkimin e bërë nga Prokuroria në shkallë të parë, gjithmonë në mbështetje të zbatimit korrekt të ligjit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta, të strukturuara, në respektim të normave të drejtshkrimit.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë nga ana e prokurorit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga aktet e dosjeve të shqyrtuara për efekt të procesit të rivlerësimit konstatohet nivel i lartë përgjegjshmërie, në administrimin e duhur të akteve ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit Dritan Peka ka pasqyruar një komunikim e bashkëpunim korrekt me kolegët, duke shkëmbyer njohuritë dhe përvojën profesionale me ta, por njëkohësisht edhe sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit prokurori Dritan Peka dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin Dritan Peka për periudhën objekt vlerësimi nuk rezulton të ketë patur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jenë diskutuar cënime të drejtave të pjesmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore vulnerable. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Subjekti i rivlerësimit Dritan Peka në periudhën e vlerësimit ka shfaqur aftësi komunikuese mjaft të mira. Bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratën, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre. Ka shfaqur një sjellje shumë të mirë, i komunikueshëm dhe duke shfaqur kompetencë profesionale në diskutime teknike, për çështje të

ndryshme. Ka aftësi shumë të mira komunikimi, bashkëbisedon pa rezerva dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

Në lidhje me vlerësimin e aftësive komunikuese, nga vlerësimet e punës së subjektit Dritan Peka për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se :

Për vitin 2014 - subjekti Dritan Peka nuk është vlerësuar nga Prokurori i Përgjithshëm pasi nuk ka qenë subjekt i vlerësimit të punës.

Për vitin 2015 - subjekti Dritan Peka është vlerësuar *“shumë mirë”* për aftësitë e komunikimit;

Për vitin 2016 - subjekti Dritan Peka është vlerësuar *“shumë mirë”* për aftësitë e komunikimit.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Ka cilësi shumë të mira bashkëpunuese, si dhe i gatshëm të punojë në grup dhe me agjensi të tjera ligjzbatuese dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët. Ka shfaqur aftësi të veçanta dhe këmbëngulje në organizimin me efektivitet të burimeve materiale dhe njerëzore të prokurorisë, duke i menaxhuar me përsosmëri këto burime.

c) Gadishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi subjekti Dritan Peka rezulton të jetë angazhuar në një sërë aktivitete profesionale të organizuara, qoftë në rolin e pjesmarrësit qoftë si lektor. Konkretisht në këtë periudhë rezulton të ketë marrë pjesë në këto aktivitete profesionale :

Ka qenë ekspert në Shkollën e Magjistraturës, dhe si i tillë ka punuar dhe prezantuar temën *“Roli i sistemit të drejtësisë në mbrojtjen dhe promovimin e standarteve të barazisë dhe mosdiskriminimit gjinor. Roli i Shkollës së Magjistraturës përmes programit të trajnimit vazhdues, vlerësimi i nevojave në këto aspekte”*. Tiranë 17 Dhjetor 2015.

Gjithashtu ka rezultuar se:

- i. Referuar të dhënave arkivore pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme për prokurorin subjekt vlerësimi, rezulton se ndaj këtij subjekti është paraqitur një ankesë nga shtetasit B. P., H. P., M. P. dhe N. P për faktin se prokurori Dritan Peka, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Tiranë nuk ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 24.04.2017;
- ii. Nga aktet e ndodhura në këtë praktikë administrative, rezulton se përgjatë gjykimit të procedimin penal nr. *** të vitit 2012, në ngarkim të shtetasit I.A., i akuzuar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve, më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda”, “Falsifikim i dokumenteve” nga personi që ka për detyrë lëshimin e tyre, e kryer në bashkëpunim, dhe “Mashttrim”, me pasoja të rënda parashikuar nga nenet 186/2, 186/3 e 25 dhe 143/2 të Kodit Penal si dhe të shtetasës E.H., e akuzuar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” nga personi që ka për detyrë lëshimin e tyre, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.
- iii. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.05.2016, ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin I. A., për akuzat e parashikuara nga nenet 186/2 dhe 186/3 e 25 të Kodit

- Penal, por e ka deklaruar fajtor të pandehurin për veprën penale të “Mashttrimit”, me pasoja të rënda, në dy raste, njëri prej tyre në tentativë, parashikuar nga neni 143/2 dhe 143/2 e 22 i Kodit Penal dhe e ka dënuar përfundimisht me 12 vjet burgim;
- iv. Ndërsa për të pandehurën E. H., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me të njëjtin vendim, ka vendosur ta deklarojë të pafajshme për veprën penale të parashikuar nga neni 186/3 e 25 i Kodit Penal.
- v. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë nga prokurori pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, dhe me vendimin nr. ***, datë 24.04.2017, Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 23.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të pandehurën E.H.; lënien në fuqi për të pandehurin I.A për sa i përket deklarimit të pafajshëm lidhur me akuzat e parashikuara nga nenet 186/2 dhe 186/3 e 25 i Kodit Penal, dhe prishjen e vendimit të lartpërmendur si dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit I.A., për veprën penale të “Mashttrimit”, në dëm të shtetasit F. P., parashikuar nga neni 143/2 e 22 i Kodit Penal dhe në dëm të shtetasit H. P., parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal.
- vi. Me shkresën nr. *** prot., datë 29.05.2017., drejtuar shtetasit H.P., Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, i bën me dije se nuk është ushtruar rekurs ndaj vendimit nr. ***, datë 24.04.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- vii. Nga ana e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme që ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga shtetasit e lartpërmendur ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Peka, pasi ka kryer verifikimet e nevojshme, është bërë një “Memo” drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm, duke konkluduar se: “Referuar vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Tiranë, prokurori i Apelit Tiranë dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Tiranë, kanë vepruar në kundërshtim me pikën 5 të Udhëzimit nr.1, datë 14.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për ushtrimin me efikasitet të së drejtës së ankimit”, pasi në rastet kur prokurori i çështjes refuzon të ushtrojë të drejtën e rekursit, atëherë Drejtuesi i Prokurorisë duhet të kishte ushtruar rekurs pavarësisht qëndrimit të prokurorit të çështjes”.
- Lidhur me rivlerësimin profesional të subjektit, si edhe konkretisht mbi problematikat e konstatuara nga Grupi i Punës, për sa i përket denoncimit të mësipërm, Komisioni, do të shprehet në vijim, gjatë dhe në konkludim të analizës së denoncimeve dhe dosjeve që ato i referohen.

C/2. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e Grupit të Punës të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe dosjet e dokumentacionin mbi të cilat, ky i fundit kishte kryer vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit; pasi studioi dhe analizoi denoncimet e publikut; para se të arrinte në konkluzionet e veta, zhvilloi hetime specifike edhe në lidhje me fakte të përshkruara në katër denoncimet e paraqitura nga publiku, dhe konkretisht:

1. Denoncim i N. P., regjistruar pranë Komisionit me nr. * prot., datë 28.12.2017.**

- i. Denoncuesja denoncon subjektin e rivlerësimit për mungesë të aftësive profesionale dhe vendim të njëanshëm. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për një çështje gjyqësore penale;
- ii. Me shkresën nr. *** prot., datë 26.09.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, ka dërguar dosjen lidhur me çështjen e denoncuar nga N. P.;
- iii. Nga përmbajtja e kësaj dosjeje konstatohen faktet e përshkruara, më lart në pikën C/1, dhe në sajë të analizës së tyre dhe të rrethanave në të cilat këto fakte janë konkretizuar, edhe trupi gjykues, në përfundim të hetimit administrativ, konkludoi se për subjektin e rivlerësimit ishin konstatuar mangësi dhe mosveprime në ushtrimin e detyrës dhe kompetencave të veta si Drejtues, përballë rastit që nuk ishte paraqitur rekurs nga prokurori e çështjes (të denoncuar) – pasi, sipas Urdhrit të Prokurorit të Përgjithshëm, plotësoheshin të gjitha kushtet për të cilat duhej që të paraqitej rekurs prej tij - si drejtues - kur prokurori i çështjes njofton qëndrimin për të mos paraqitur rekurs.

1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me mosparaqitjen e rekursit në fjalë.

- i. *Subjekti ka shpjeguar se veprimtaria e tij si drejtues, në lidhje me këtë çështje, ka qenë ligjore, korrekte, profesionale dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;*
- ii. *Për sa më lart, subjekti e mbështet në faktin se, atij i ishte komunikuar me shkrim nga prokurori i çështjes L.K., se ky i fundit do të paraqiste rekurs, ndaj vendimit të gjykatës së apelit në fjalë;*
- iii. *Për rrjedhojë, ai nuk mund të vepronte për paraqitje rekursi, pa pasur informacionin e mosparaqitjes së rekursit nga prokurori i çështjes.*

1.2 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet

- i. Trupi gjykues, pasi ka shqyrtuar argumentimin dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, - ndryshe nga sa ishte konstatuar nga Grupi i Punës së Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni, - çmon se konkretisht ky i fundit, nuk ka pasur detyrimin dhe mundësinë të vepronte personalisht, si Drejtues, për paraqitjen e rekursit për sa kohë këtë akt do ta kryente prokurori i çështjes në fjalë;
- ii. Ky konkluzion del nga rrethanat e reja të paraqitura nga subjekti - nëpërmjet dokumentit më datë 27.04.2017, - me të cilin prokurori i apelit, L.K., ka përcjellë informacion tek Drejtuesi (*subjekti*) lidhur me ecurinë e çështjes kundër të pandehurit I.A., dhe në përmbyllje të informimit, shprehet qartazi se ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, (më datë 24.04.2017), do të ushtrohet rekurs;
- iii. Fakti i mësipërm e shkarkon subjektin e rivlerësimit nga përgjegjësia për mosushtrim të rekursit, pasi ai do të duhej të vepronte vetëm nëse prokurori i çështjes do të kishte shprehur qëndrim të kundërt – pra që prej tij nuk do të paraqitej rekurs ndaj vendimit të sipërcituar.

2. Denoncim i N.C., regjistruar pranë Komisionit me nr. * prot., datë 25.05.2018.**

Shtetasi N.C. është ankuar ndër të tjerë edhe ndaj subjektit të rivlerësimit, me objekt: “Krim të organizuar”. Denoncuesi ka paraqitur një *link* të cilit mund t’i referohemi për provat e nevojshme, por nuk janë konstatuar përfshirje apo përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit në lidhje me përmbajtjen e denoncimit.

3. Denoncim anonim me pseudonim A.K.

Ai denoncon subjektin e rivlerësimit pasi me veprimet e tij dhe të gjyqtarëve të tjerë ka korrupsion dhe shpërdorim të detyrës. Bashkëlidhur rezulton vendimi nr. *** i Gjykatës së Apelit Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka ndjekur çështjen dhe ka kërkuar vlerësim të ligjshëm të arrestit për shtetasin B.SH. dhe masën e sigurimit “Arrest në burg”. Gjykata ka vendosur vlerësim e ligjshëm të ndalimit dhe ndryshimin e masës së sigurisë në detyrim paraqitje.

Pasi janë shqyrtuar aktet në dispozicion, nuk janë konstatuar elemente përbërës apo indice të korrupsionit apo të shpërdorimit të detyrës, siç është pretenduar/shprehur nga denoncuesi, pasi subjekti ka kërkuar aplikimin e masës më të rëndë të mundshme ndaj shtetasit në fjalë, dhe nuk vërehet asnjë tentativë favorizimi.

4. Denoncim i paraqitur nga publiku pranë Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, më datë 20.09.2018.

Komisioni ka kryer një procedurë hetimore lidhur me mbledhjen e fakteve dhe provave për çështjet/problematikat e përmendura në këtë denoncim.

Sipas denoncimit, subjekti i rivlerësimit si drejtues i Prokurorisë së Apelit Tiranë kishte kryer një sërë shkeljesh si vijon:

- i. *Nga muaji tetor i vitit 2016 e në vazhdim për veten e tij nuk shqyrton dosje. Vetëm në një rast ka shqyrtuar dosjet dhe kjo është në muajin shkurt 2018;*
- ii. *Denoncuesi, më datë 21.03.2017, ka qenë prokuror i gatshëm lidhur me masat e sigurimit ku kanë qenë për shqyrtim në 5 çështje. Atë ditë denoncuesi është thirrur nga subjekti i rivlerësimit dhe ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes me palë të pandehur A.R.;*
- iii. *Pasi denoncuesi nuk ka pranuar, subjekti i rivlerësimit, ka marrë dosjen në mënyrë arbitrare dhe ka caktuar një prokuror tjetër në kundërshtim me ligjin;*
- iv. *Subjekti i rivlerësimit ka emëruar, z. A. M., në pozicionin “Teknik i specialiteteve të ndryshme dhe magazinier” në kundërshtim me kriteret, arsimimin dhe pozicionin e vendit të punës.*
- v. *Subjekti i rivlerësimit në vitin 2015 ka miratuar lejen vjetore për punonjës A. M. Ky punonjës ka kryer lejen vjetore të paguar jo për periudhën e caktuar, por për një periudhë më të gjatë.*
- vi. *Nga subjekti i rivlerësimit i është komunikuar kancelares së prokurorisë se punonjësi A. M. do vazhdonte të qëndronte jashtë vendit dhe pagesa do t’i kryhej pa qenë prezent në vendin e punës.*
- vii. *Nga ana e kancelares nuk janë firmosur listëprezencat pasi kjo përbënte shkelje ligjore.*

4.1 Bazuar në këtë denoncim nga ana e Komisionit u kryen veprimet hetimore si më poshtë:

- i. Me shkresën nr. *** prot., datë, 5.10.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, ka dërguar praktikën që disponon për një kopje të praktikës që ka të bëjë me vendimin gjyqësor me palë prokurorinë kundër të pandehurit A. R. Me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2018, është kërkuar informacion pranë Prokurorisë së Apelit, lidhur me çështjen penale të ndjekur nga prokuroria

- kundër të pandehurit A. R. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, me shkresën nr. ***, datë 25.10.2018, ka kthyer përgjigje duke dërguar praktikën përkatëse;
- ii. Sipas kësaj shkrese është deklaruar se: *“Masat e sigurimit ndahen sipas sistemit të gatishmërisë së prokurorëve; sipas grafikut për masat e sigurimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, më datë 25.05.2016, prokuroria është përfaqësuar nga prokurori N. Gj. Ndërsa, më datë 28.03.2017, ankimi ndaj masës së sigurimit është përfaqësuar nga prokurori L. K., për shkak të radhës së gatishmërisë”*;
 - iii. Me shkresën nr. *** prot., datë 25.09.2018, iu kërkuan të dhëna zyrës së kancelarit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Të dhënat u kërkuan në lidhje me procedurën e rekrutimit të z. A. M, kategorinë e pagës në raport me pozicionin e punës dhe procedurat e ndjekura për miratimin e lejes së zakonshme të pagueshme nga viti 2015 deri më sot;
 - iv. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2018, Prokuroria e Apelit Tiranë, ka kthyer përgjigje ku thekson se kancelaria e Prokurorisë së Apelit Tiranë nga data 24.08.2018 deri më datë 17.10.2018, është me leje të zakonshme dhe se kërkesa do t'i përcillet kancelares pas kthimit në punë²⁴;
 - v. Me shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2018, kancelaria e Prokurorisë së Apelit Tiranë, ka dërguar informacion dhe dokumentacion. Sipas dokumentacionit të dërguar rezulton se: *“Dosja personale e z. A. M. është tërhequr në momentin e transferimit të tij në Prokurorinë e Përgjithshme”*;
 - vi. Sipas shkresës nr. *** prot., datë 30.01.2015, të Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për plotësimin e vendeve të lira të punës, duhet të kërkohej paraprakisht miratimi nga Prokurori i Përgjithshëm;
 - vii. Me shkresën nr. *** prot., datë 02.02.2015, firmosur nga subjekti i rivlerësimit, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, është kërkuar dhënia e miratimit për emërimin e z. A. M në pozicionin “teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë;
 - viii. Në urdhrin nr. *** prot., datë 06.02.2015, të firmosur nga subjekti i rivlerësimit, z. A. M., do të paguhet sipas lidhjes II, Klasa VI të VKM-së, nr. 610, datë 24.07.2013, të ndryshuar²⁵;
 - ix. Më datë 06.02.2015, është lidhur kontratë pune midis subjektit të rivlerësimit dhe z. A. M., për pozicionin “teknik i specialiteteve të ndryshme dhe magazinier”;
 - x. Me urdhrin nr. *** prot., datë 06.07.2015, është miratuar nga subjekti i rivlerësimit leja e zakonshme për z. A. M. nga data 1 gusht 2015 deri më 7 gusht 2015;
 - xi. Listëprezencat e punonjësve të Prokurorisë së Apelit për periudhën shkurt 2015 deri në qershor 2015, të konceptuar nga kancelaria e prokurorisë dhe firmosur nga subjekti i rivlerësimit;
 - xii. Listëprezencat e punonjësve të Prokurorisë së Apelit Tiranë për periudhën korrik 2015 deri në tetor 2015, pa firmë se kush e ka konceptuar dhe firmosur nga subjekti i rivlerësimit;

²⁴ Ndërkohë Institucioni në fjalë – i drejtuar nga subjekti – me sa duket, nuk kishte një person që të kryente funksionin e kancelares, dhe për rrjedhojë të përmbushte kërkesën e paraqitur nga Komisioni brenda afateve ligjore - për aq kohë sa ajo ishte me leje të zakonshme...?!

²⁵ Kush e ka kompetencën teknike për të përcaktuar nivelin e pagesës? Me cilin ekspert është konsultuar vendimmarrësi më përpara sesa të firmoste këtë urdhrë?

- xiii. Bordero page për punonjësit e Prokurorisë së Apelit Tiranë për periudhën shkurt 2015 deri më dhjetor 2015, ku rezulton pagesa e bërë dhe me vulën e degës së thesarit për të gjithë punonjësit dhe për z. A. M.:
- xiv. Me shkresën nr. *** prot., datë 25.09.2018, Komisioni i ka kërkuar Prokurorisë së Apelit Tiranë, një listë për të gjitha çështjet penale për të cilat është vendosur mosparaqitja e ankimit apo rekursit për periudhën janar 2016 - qershor 2018 dhe procedura e ndjekur për hedhjen e shorteve për caktimin e prokurorëve të çështjeve penale. Gjithashtu, është kërkuar kopje e akteve të brendshme të Prokurorisë që normojnë procedurat lidhur me ankimin dhe përgatitjen e rekursit;
- xv. Me shkresën nr. ***prot., datë 09.10.2018, Prokuroria e Apelit Tiranë ka kthyer përgjigje duke pohuar, veç të tjerash se:
- a. *Dosjet e themelit ndahen në bazë të shortit manual dhe bëhet transparent në prani të të gjithë prokurorëve dhe drejtuesi i prokurorisë merr 50% të çështjeve; Masat e sigurimit ndahen sipas grafikut të gatshëm;*
 - b. *Rastet e ndryshimit të prokurorëve të çështjeve janë bërë vetëm me kërkesë të prokurorit ose kur kërkohet nga palët; Në rastet e zëvendësimit është ndjekur procedura sipas neneve 26 dhe 27 të Kodit të Procedurës Penale;*
 - c. *Në 4 vite që subjekti ka drejtuar këtë Institucion ka pasur vetëm 4 raste të zëvendësimit të prokurorit; bashkëlidhur janë dërguar, udhëzimi nr. 3, datë 29.12.2016, dhe rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë.*
- xvi. Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2018, është kërkuar mendim nga Prokuroria e Përgjithshme lidhur me çështjet e trajtuara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të kërkesës së Komisionit, të dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 09.10.2018, dhe nr. ***prot., datë 27.09.2018;
- xvii. Me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2018, Prokuroria e Përgjithshme ka kthyer përgjigje ku deklaron: *“Në lidhje me evidentimin e të dhënave nominative për çështjet të cilat nuk është ushtruar rekurs, kjo çështje nuk gjen rregullim ligjor dhe ngelet në diskrecionin e prokurorisë për të evidentuar të dhënat; Udhëzimet e drejtuesit të prokurorisë për çështje konkrete nuk janë të detyrueshme për prokurorët e çështjes; shpërndarja e dosjeve bëhet në mënyrë manuale; Lidhur me marrjen e lejes së zakonshme të z. A. M. është kërkuar pranë Prokurorisë së Tiranës “vlerësim i rastit të audituar dhe zgjidhjes sipas ligjit”;*
- xviii. Prokuroria e Rrethit Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 16.07.2018, ka dërguar vendimin për mosfillim të procedimit penal;
- xix. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 05.10.2018, i kishte kërkuar Ministrisë së Financave të kryente një inspektim mbi punësimin dhe pushimet e paguara të z. A. M., por kjo e fundit nuk e ka parë të arsyeshme të fillonte një inspektim, pasi rrethanat e çështjes lidhur me përfitimin e paligjshëm të z. A. M. rezultonin të provuara. Për këtë shkak, ajo e përcolli dosjen në Prokurorinë e Apelit Tiranë, së bashku me një kërkesë specifike për të saktësuar shumat e sakta të përfituara në mënyrë të paligjshme nga z. M. në dëmin e buxhetit të shtetit shqiptar;

- xx. Nga Komisioni i është dërguar *e-mail* kancelares së Prokurorisë së Apelit Tiranë duke i kërkuar sqarime lidhur me rrethana dhe fakte mbi procedurat e emërimit të z. A. M. dhe procedurat e miratimit të lejes vjetore në vitin 2015;
- xxi. Më datë 27.11.2018, kancelaria e Prokurorisë së Apelit Tiranë, ka dërguar përgjigjen lidhur me pyetjet e bëra nga Komisioni. Në përgjigje, në mënyrë të përmbledhur ka deklaruar:
- a. *Jam në dijeni të emërimit të z. A. M., por për sa i përket procedurave të emërimit të tij ju sqaroj se emërimi është bërë me propozim të titullarit dhe se kancelari nuk ka asnjë kompetencë në emërimet e punonjësve të administratës së prokurorive;*
 - b. *Për pozicionin e z. A. M., nuk është bërë asnjë shpallje për vendin vakant, por është bërë direkt një kërkesë për emërim kuadri, për punonjës në fjalë, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme. Kërkesa është bërë nga Drejtuesi i Prokurorisë;*
 - c. *Për sa i përket kualifikimit dhe formimit profesional dhe arsimor të z. A. M., nuk përputhet me pozicionin e vendit të punës dhe me pagën përkatëse. Për këtë kam pasur kundërshtimin tim drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë;*
 - d. *Struktura përgjegjëse për përgatitjen e listëprezencave mujore dhe përfshirjen në të të lejeve vjetore të pagueshme të punonjësve të Prokurorisë së Apelit Tiranë është kancelari dhe pastaj firmoset nga Drejtuesi i Prokurorisë;*
 - e. *Për periudhën korrik - shtator 2015, listëprezencat janë përpiluar prej meje, por nuk kam pranuar t'i firmos sepse nuk kam qenë dakord me urdhrin e Drejtuesit për t'i firmosur në kushtet e mosprezencës së tij në punë. Ndaj, listëprezencat janë firmosur vetëm prej titullarit; z. A. M. nuk ka qenë prezent në punë gjatë periudhës korrik – shtator 2015;*
 - f. *Mbi këto fakte kam qenë në dijeni jo vetëm unë, por të gjithë punonjësit e Prokurorisë së Apelit Tiranë;*
 - g. *Kancelari nuk ka asnjë rol lidhur me dhënien, kohëzgjatjen dhe miratimin e lejeve vjetore. Janë kompetencë direkt e Drejtuesit të Prokurorisë.*
- xxii. Më datë 12.12.2018, pranë selisë së Komisionit është dëgjuar dhe pyetur si person deklarues, kancelaria e Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, znj. S., e cila ka pohuar dhe konfirmuar të gjitha faktet, si më lart, të deklaruara edhe më herët nëpërmjet *e-mail-it*²⁶;
- xxiii. Nga verifikimet e sistemit *TIMS* rezultonte se, z. A. M, lindur më 21.08.1983, në Elbasan, kishte kryer daljen e fundit nga territori shqiptar, më datë 26.06.2015, në drejtim të qytetit të Barit, Itali, dhe çuditërisht nuk konstatohet data e hyrjes së tij në Shqipëri, dhe as ndonjë dalje apo hyrje tjetër në vitet e mëpasshme.

4.2 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me gjetjet dhe me përmbajtjen e denoncimit në fjalë.

²⁶ Sipas procesverbalit të datës 12.12.2018.

Subjekti i rivlerësimit, lidhur me faktet e përshkruara në denoncimin në fjalë, - veç sa është paraqitur më sipër, nëpërmjet shkresave institucionale - ka pohuar, shpjeguar dhe ka depozituar dokumentacion mbështetës, si në vijim:

4.2/a – Lidhur me shpërndarjen, administrimin dhe transferimin e dosjeve:

- i. Subjekti ka pohuar se ai i ka shpërndarë dosjet gjithmonë me short, - me përjashtim të atyre çështjeve që lidheshin me masa sigurimi - dhe ka pasur edhe personalisht një ngarkesë dosjesh (95 në 2016; 89 në 2017 dhe 121 çështje themeli, plus 90 masa sigurie në vitin 2018), pra më shumë se gjysma e atyre që u shpërndahej prokurorëve të tjerë;
- ii. Për sa më lart, bazohet në dokumentet statistikore të përpunuara dhe të paraqitura në rrugë zyrtare pranë këtij Komisioni;
- iii. Lidhur me dosjen e të pandehurit A. R, subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur asnjë ndryshim të prokurorit të kësaj dosjeje nga ana e tij, por thjesht përfaqësimi për masat e sigurisë kryhet jo nga prokurori i gatshëm, i cili nuk ka një vijimësi me atë çështje, pra nëse e njëjta dosje do të rishqyrtohej në lidhje me masën e sigurisë, në sajë të një kërkesë të re për ndryshimin e kësaj të fundit, ajo do të përfaqësohej nga prokurori i gatshëm dhe jo nga ai që e kishte përfaqësuar çështjen në seancën pararendëse;
- iv. Lidhur me sa më lart, në mbështetje të argumentimit të vet, subjekti ka paraqitur disa dokumente që pasqyrojnë grafikun e gatishmërisë së prokurorëve të apelit në lidhje me masat e sigurimit personal.

4.2/b – Lidhur me punësimin e z. A. M., pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë si dhe me pushimet e pagesën e tij gjatë verës së vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka pohuar se:

- v. Për pozicionin profesional që ka mbuluar z. A. M. (*punonjës magazine*), nuk parashikohej kryerja e shpalljes së vendit të lirë të punës për procedurën e rekrutimit, si dhe nuk kërkohej ndonjë kriter shkollimi, për rrjedhojë punësimi i tij pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, ishte kryer komfor dispozitave ligjore në fuqi, sipas kodit të punës dhe vendimmarrja ishte njoftuar paraprakisht edhe pranë Prokurorisë së Përgjithshme;
- vi. Gjithashtu, duke cituar përmbajtjen e VKM-së, nr. 717/2009, subjekti argumenton se nga kjo dispozitë rezulton se pozicionet si “teknik të mesëm të specialiteteve të ndryshme” nuk përfshihen midis atyre që duhet rekrutuar me shpallje, si dhe përcaktimi i pagës – klasa VI, si nivel i pagës bazë për këtë emërtesë – që përkon me atë të marrë nga z. A. M.;
- vii. Procedura e marrjes në punë të z. A. M. ka qenë detyrë dhe është ndjekur nga kancelaria e institucionit, pasi këtë detyrë ia jep asaj VKM-ja nr. 117/2014, si dhe rregullorja e brendshme e institucionit në fjalë (*neni 10, shkronja “l”*);
- viii. Për sa i përket periudhës së lejes të marrë nga z. A. M., subjekti shpjegon se në bazë të urdhrit të tij, nr. 5, datë 06.07.2015, është miratuar/akorduar leje për z. A. M., nga data 1 deri në 7 gusht 2015 – sipas kërkesës së paraqitur nga i punësuari;
- ix. Lidhur me mungesën e z. A. M. nga vendi i punës për një periudhë më të gjatë se leja e miratuar, subjekti shprehet se ai nuk ka pasur dijeni apo njoftim mbi një rrethanë të tillë, pasi verifikimi i punonjësve mbi prezencën e tyre apo jo, në vendin e punës, është kompetencë dhe detyrë e

kancelares (sipas *pika 1, nenit 10, shkronja "c" e rregullores së institucionit*) e cila nuk më ka raportuar një gjë të tillë;

- x. Lidhur me listëprezencat e periudhës korrik – tetor 2015, subjekti ka argumentuar se ato përgatiteshin gjithmonë nga kancelaria, pikërisht në bazë të verifikimeve të saj lidhur me prezencat e punonjësve, dhe si praktikë firmoseshin nga drejtuesi i institucionit. Pra, përderisa kancelaria nuk kishte raportuar ndonjë mungesë nga detyra të punonjësit në fjalë, nuk kishte arsye për të mos i firmosur listëprezencat në fjalë;
- xi. Pra, sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore, detyrimi ligjor për verifikimin e prezencave dhe hartimin dhe plotësimin e saktë të listëprezencave, si dhe përgjegjësitë për një pasaktësi bien mbi kancelaren e institucionit;
- xii. Pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, është kryer një auditim i përgjithshëm, për periudhën 01.01.2015 – 31.12.2017, nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nuk është konstatuar asnjë lloj shkelje – as në lidhje me mosfirmosjen e listëprezencave për periudhën korrik-tetor 2015;
- xiii. Nga ana tjetër Prokuroria e Rrethit Tiranë ka kryer një verifikim të fakteve në fjalë dhe ka çmuar se bëhej fjalë për rrethana të natyrës administrative dhe se nuk kishte vend për çeljen e një hetimi, dhe për rrjedhojë ka vendosur për mosfillim të një procedimi penal;
- xiv. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur 7 fletëhyrje të furnizimeve që Prokuroria e Përgjithshme ka kryer me materialeve të ndryshme pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, të cilat rezultojnë të jenë marrë në dorëzim nga z. A. M., përgjatë periudhës 01.07.2015 – 13.10.2015, të firmosura nga ky i fundit;
- xv. Po ashtu, subjekti ka paraqitur 27 fletëdalje, të periudhës 30.06.2015 – 31.08.2015, nga të cilat rezulton se z. A. M., në cilësinë e magazinierit ka shpërndarë/dorëzuar materiale të ndryshme tek prokurorët e apelit si dhe tek vetë kancelaria e institucionit;
- xvi. Për sa më lart, subjekti ka paraqitur edhe 20 fletëdalje, të periudhës 02.09.2015 – 17.09.2015, nga të cilat rezulton se z. A. M., në cilësinë e magazinierit ka shpërndarë/dorëzuar materiale të ndryshme tek prokurorët e apelit si dhe tek vetë kancelaria e institucionit;
- xvii. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur 46 fletëdalje, të periudhës 01.06.2015 – 18.09.2015, nga të cilat rezulton se z. A. M., në cilësinë e magazinierit ka shpërndarë/dorëzuar materiale të ndryshme tek prokurorët e apelit si dhe tek vetë kancelaria e institucionit – të cilët kanë firmosur çdo fletëdalje, sikundër ato rezultojnë të jenë të firmosura edhe nga vetë z. A. M..

4.3 Arsyetimi ligjor në lidhje me faktet e përshkruara më sipër.

Pikë se pari, duhet theksuar se, lidhur me rrethanat e sipër përshkruara, Komisioni, ka administruar informacione dhe elementë provues kontradiktor, vërtetësia dhe gjeneza e të cilëve nuk mund të verifikohet dhe kristalizohet plotësisht dhe në mënyrë shteruese brenda kornizave të këtij hetimi administrativ. Ky deduksion arrihet nga trupi gjyqësor, në funksion të kufizimit të kompetencave specifike lëndore të këtij Komisioni, të cilat, në rastin konkret, nuk e mundësojnë një qartësim dhe një verifikim shterues mbi autenticitetin dhe vërtetësinë e dokumentacionit dhe të deklarimeve të administruara;

Natyrisht, rivlerësimi i subjektit kalon edhe nëpërmjet një verifikimi/analize të aftësive të tij profesionale dhe etike, përfshirë këtu edhe qëndrimin e mbajtur përgjatë procesit të rivlerësimit, si

dhe vërtetësinë e deklarimeve/pohimeve dhe dokumenteve të paraqitura prej tij. Ndërsa kjo nuk ndodh me deklaratimet dhe dokumentet e paraqitura nga persona të tretë, të cilat mund të vlerësohen nga Komisioni vetëm për sa kohë ato prodhojnë efekte qartësuese, vërtetuese apo përgënjeshtuese të një fakti konkret që lidhet apo që është objekt shqyrtimi në brendësi të procesit të rivlerësimit. Në çdo rast, trupi gjykues, mbërrin në konkluzionet dhe bindjet e veta në sajë të një vlerësimi administrativ të informacioneve dhe deklaratave të grumbulluara, si dhe të dokumenteve dhe provave të administruara, që kanë prejardhje nga burime të ndryshme, por jo gjithmonë, Komisioni, mund të verifikojë apo të shprehet përfundimisht mbi autenticitetin e dokumenteve dhe mbi vërtetësinë e plotë të përmbajtjes së tyre, dhe për rrjedhojë, - edhe në kuadrin e respektimit të procesit të rregullt ligjor, - shpesh i duhet t'i konsiderojë disa elementë provues si të mirëqena, për sa kohë mungon prova e kundërt, edhe në prezencën e ndonjë dyshimi në këtë aspekt - duke e përcjellë, më pas, në organin kompetent për verifikimet e mëtejshme mbi autenticitetin dhe vërtetësinë e materialit në fjalë;

Në lidhje me rastin konkret, trupi gjykues, vëren se:

4.3/a Denoncimi nr. 4, në pjesën e tij të parë aludonte se subjekti, në pozicionin e drejtuesit të institucionit, prej shume kohësh nuk kishte shortuar dosje për vete, dhe për rrjedhojë nuk kishte përfaqësuar institucionin përpara Gjykatës së Apelit, si dhe kishte hequr një dosje, në mënyrë arbitrare dhe jashtë kompetencave, për t'ia kaluar një tjetër prokurori – kundër vullnetit të denoncuesit;

Në lidhje me këto pretendime Komisionit i rezultojnë se:

- i. Të dhënat statistikore të ngarkesës së punës, lidhur me dosjet e përfaqësuar në Gjykatën e Apelit, tregojnë se pretendimet e ngritura në denoncimin në fjalë nuk qëndrojnë, pasi rezultojnë se subjekti ka përfaqësuar 95 dosje në vitin 2016; 89 dosje në vitin 2017 dhe në vitin 2018 ka përfaqësuar 121 dosje themeli dhe 90 dosje që lidheshin me masa sigurie²⁷;
- ii. Lidhur me dosjen e të pandehurit A. R, nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se ndryshimi i prokurorit ka ndodhur brenda një dinamike normale të funksionimit të shpërndarjes së dosjeve që trajtoheshin për masa sigurimi personal, ku për çdo periudhë kishte prokurorë të gatshëm, dhe prokurori që kishte përfaqësuar një dosje në vlerësimin e masës, nuk do të ishte domosdoshmërisht i njëjtë edhe në rast të riparaqitjes së dosjes për një tjetër rishqyrtim, pasi prokurori i parë – në sajë të praktikës së institucionit – nuk e ndiqte më atë dosje, por ajo i kalonte prokurorit të gatshëm, sipas grafikut të paracaktuar nga drejtuesi. Dhe pikërisht kjo procedurë/dinamikë ka mundësuar përfaqësimin e kryer nga prokurori L. K., më datë 28.03.2017, në seancën e mbajtur përpara Gjykatës së Apelit Tiranë²⁸.

4.3/b Në lidhje me punësimin e z. A. M., pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, si dhe me pushimet e pagesën e tij gjatë muajve korrik - tetor të vitit 2015, ka rezultuar se:

- i. Pretendimet se lidhja e kontratës së punës me z. A. M. është kryer në mosrespektim të parashikimeve ligjore nuk rezultojnë të provuara, pasi është konstatuar se kontrata në fjalë është

²⁷ Duke iu referuar të dhënave të paraqitura nga subjekti.

²⁸ Duke iu referuar regjistrit përkatës të dosjeve për masa sigurimi; grafikut të depozituar nga subjekti dhe akteve të dosjes në fjalë.

lidhur në respekt të dispozitave të Kodit të Punës – fillimisht me një kontratë prove, tre mujore, dhe më pas është lidhur kontrata pa afat;

- ii. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, si dhe nga referencat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë mënyrat dhe procedurat e rekrutimit për plotësimin e vendeve të lira të punës, nuk rezulton që për tipologjinë specifike të vendit të punës si magazinier, të kërkohet një procedurë shpallje dhe konkurrimi, dhe as kritere specifike përjashtuese;
- iii. Gjithsesi, në lidhje me këtë marrëdhënie pune – siç do të detajohet edhe më tej – rrethana e veçantë qëndron në faktin se pikërisht personi që kishte detyrën për të ushtruar procedurën përgatitore të lidhjes së një marrëdhënie të re pune, ishte pikërisht kancelaria e institucionit;
- iv. Natyrisht, nëse do të rezultonin shkelje të kësaj natyre, subjekti i rivlerësimit, nuk do të ishte pa përgjegjësi, përkundrazi, ai në cilësinë e drejtuesit dhe përfaqësuesit të institucionit në aktin e lidhjes së kontratës së punës do të kryente një shkelje të rëndë nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të paligjshme. Por ky fakt nuk rezulton i provuar nga dokumentacioni i administruar dhe nuk është konstatuar as nga auditi i kryer nga Prokuroria e Përgjithshme.²⁹ Për më tepër, nëse nga hetimi i organeve kompetente do të rezultonte vetëm një neglixhencë apo një pakujdesi e tij në administrimin e kësaj rrethane, kjo do të tregonte paaftësinë e tij për të mbuluar funksionin e drejtuesit të këtij Institucioni, dhe nuk mund të ndikojë, automatikisht, në aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit si prokuror i thjeshtë;
- v. Për sa i përket periudhës së lejes së kryer nga z. A. M., në verën e vitit 2015, rezulton formalisht e provuar se ai ka kërkuar dhe i është miratuar leje për periudhën nga data 1 deri në datën 7 gusht 2015 - sipas urdhrin nr. 5, të drejtuesit, të datës 06.07.2015;
- vi. Lidhur me një sërë elementësh që ndërthuren me këtë marrëdhënie pune është konstatuar një paqartësi kontradiktore që gjeneron dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë e disa pohimeve, deklarimeve, denoncimeve apo të disa dokumenteve, të gjitha të administruara nga Komisioni, në tentativë për t'i dhënë përgjigje disa pyetjeve (dyshuese), dhe konkretisht:
 - a. *Për çfarë arsye listëprezencat e muajve korrik, gusht, shtator 2015, nuk janë nënshkruar edhe nga kancelaria e Prokurorisë së Apelit Tiranë, por ato mbajnë vetëm firmën e drejtuesit të këtij institucioni?*
 - b. *Nëse realisht, z. A. M., ka munguar në punë për rreth 3 muaj, - për më tepër duke u paguar rregullisht, sikur të ishte në punë - përse kancelaria nuk e njoftoi në mënyrë shkresore drejtuesin e institucionit lidhur me këtë mungesë? Përse ajo nuk e denoncoi menjëherë në organe të tjera kompetente këtë fakt (që sipas saj ka ndodhur realisht)?*
 - c. *Për sa kohë ka munguar në punë, z. A. M., në verën e vitit 2015 dhe për sa kohë ai ka qëndruar jashtë shtetit shqiptar, pas daljes së tij drejt Italisë, më datë 26.05.2015?*
 - d. *Përse subjekti nuk mbajti qëndrim ndaj kancelares, duke propozuar ndonjë masë ndaj saj, apo duke e kallëzuar atë për shpifje, nga momenti që ai u bë me dije mbi denoncimet dhe deklaratimet e saj, si në Prokurorinë e Përgjithshme ashtu edhe pranë këtij Komisioni, lidhur me shkeljet e pretenduara si të kryera nga subjekti, (nëpërmjet urdhëresave gojore dhe presionit e tij për të*

²⁹ Referuar edhe më lart, për periudhën 2015 – 2017.

punësuar, në mungesë të plotësisimit të kriterëve, dhe për të paguar z. A. M., edhe pse subjekti i rivlerësimit e dinte mirë që ai nuk ishte paraqitur në punë për rreth tre muaj)?

- vii. Atëherë, nëse edhe vetëm disa nga pyetjet e mësipërme do të gjenin përgjigje shteruese, ndoshta do të mundësonin qartësimin dhe pozicionimin edhe të disa përgjigjeve të tjera, por siç u tha edhe më sipër, informacionet dhe provat që lidhen me këto fakte/pyetje janë ose të pjesshme ose kontradiktore me njëra tjetrën apo me burime të tjera;
- viii. Nga njëra anë, kancelaria e prokurorisë denoncon fakte, që ajo vetë duhej t'i kishte verifikuar dhe komunikuar zyrtarisht drejtuesit. Rezulton që në pjesën e dytë ajo nuk e ka kryer detyrën e saj në kohën e duhur;
- ix. Ky element i fundit mund të zbehtë disi besueshmërinë mbi vërtetësinë e fakteve të denoncuara, por nga ana tjetër, në mbështetje të versionit të kancelares, qëndron fakti që ajo nuk i ka firmosur listëprezencat e muajve korrik-gusht-shtator 2015. Ky fakt të çon në arsyetimin se vërtet ka pasur diçka që nuk shkonte në ato listëprezencat përderisa ajo ka refuzuar t'i firmosë – sipas saj për të mos marrë përgjegjësinë e aprovimit të pagesës për dikë që nuk ishte paraqitur në punë në ato muaj;
- x. Alternativa e këtij versioni do të mund të ishte mosfirmosja e qëllimshme për të krijuar një shkak/akuzues ndaj subjektit, por kjo veç faktit që nuk provohet, do të duhej të mbështetej mbi konfliktin e mëparshëm, i cili mund të kishte qenë nxitësi i veprimtimit të mëpasshëm hipotetik. Por këto janë veç aludime, të ngritura edhe nga subjekti, por që nuk mund të përdoren si shtylla mbi të cilat do të mund të mbështetej një vendim, në mungesë të provave;
- xi. Nëse burimet e informacioneve dhe provave të grumbulluara do të përfundonin këtu, në bazë të deklaramenteve të kancelares pranë Komisionit dhe duke u mbështetur edhe në dokumentacionin (listëprezencat) që ajo paraqiti, rezultatet e hetimit të arritura mbi këtë pikë, do të ishin transformuar të njëjta edhe në konkluzionet e këtij vendimi, duke konstatuar përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë rrethanë misterioze;
- xii. Por, nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit, në fazën e përgjigjeve dhe prapësimeve të tij - pasi ishte njohur me rezultatet e hetimit - si dhe gjatë seancës dëgjimore, paraqiti shpjegime dhe argumentime, të shoqëruara me dokumentacion mbështetës, të cilat e ndryshuan ndjeshëm nivelin bindës dhe besueshmërinë e akuzave të përcjella nëpërmjet denoncimit në fjalë;
- xiii. Për sa më lart, erdhi si rezultat fakti që ndryshe nga sa thuhej në denoncim mbi mosplotësimin e kriterëve për marrjen në punë të magazinierit, pa shpallje të vendit bosh, u konstatua se në rastin konkret nuk ishte i parashikuar si detyrim që të kryhej një shpallje për konkurrim të kandidatëve dhe nuk kishte as kritere përjashtimore që z. A. M. të mos i plotësonte;
- xiv. Por për më tepër, subjekti paraqiti një sërë dokumentesh zyrtare të cilat provojnë – deri në provën e kundërt – prezencën e z. A. M. në vendin e tij të punës përgjatë muajve korrik-gusht-shtator 2015, pasi të gjitha fletëdaljet dhe fletëhyrjet – të datave të ndryshme dhe të shpërndara në të gjithë këtë periudhë kohore – rezultojnë të nënshkruara nga z. A. M..
- xv. Për më tepër, fletëdaljet janë të firmosura edhe nga marrësit e materialeve të cilat magazinieri jua ka dorëzuar në datat përkatëse. Nënshkruesit që kanë marrë në dorëzim materialet e pasqyruara në fletëdaljet në fjalë, janë prokurorët e Prokurorisë së Apelit Tiranë;

- xvi. Veç të tjerash, nga disa fletëdalje, rezulton që vetë kancelaria të ketë tërhequr materiale nga magazina – gjatë kësaj periudhe – edhe pse ajo ka denoncuar më pas, pikërisht mungesën e magazinierit përgjatë periudhës së sipërcituar, periudhë në të cilën vetë ajo ka firmosur fletëdaljet që provojnë se magazinieri i ka dorëzuar asaj materialin që i nevojitej, pra që z. A. M. ka qenë në vendin e tij të punës;
- xvii. Për sa më lart, duke pasur parasysh kontradiktoritetin e plotë midis akuzave gojore, të mbështetura në dokumente që nuk i provojnë plotësisht ato dhe provave dokumentare të paraqitura nga subjekti, të cilat – deri në provën e kundërt – provojnë prezencën e z. A. M. në vendin e tij të punës, trupi gjykues, çmon se edhe pse ngelin dyshime mbi këtë rrethanë, nuk ka prova të mjaftueshme dhe bindëse që subjekti i rivlerësimit ka vepruar me vetëdije në shkelje ligjore, për lidhjen e kontratës së punës me z. A. M., dhe për pagesën e tij për tre muaj, duke e ditur që ai nuk ishte në punë, dhe për rrjedhojë nuk mund ta konsiderojë këtë fakt një mangësi etiko - profesionale, apo si mangësi në aftësitë drejtuese e menaxheriale;
- xviii. Gjithsesi, pikërisht në bazë të dyshimeve të përshkruara edhe më lart, dhe duke pasur parasysh që mbi këtë rrethanë janë përfshirë edhe institucione të tjera, por që ende nuk kanë hedhur mjaftueshëm dritë, për të shteruar totalisht dyshimet dhe për të dhënë përgjigje të plota, së paku pyetjeve të ngritura më sipër, trupi gjykues, çmon se kjo praktikë duhet të transferohet, sipas nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve apo shkaqeve të mundshme që përbëjnë shkelje disiplinore;
- xix. Në konkluzion, Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Peka, e arrin së paku, nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në një vlerësim dhe konkluzion të përgjithshëm, trupi gjykues, pasi konstatoi se:

a- në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, subjekt i rivlerësimit:

1. Ka kryer pasaktësi të vogla në deklaratimet periodike, nga të cilat nuk rezulton si pasojë fshehja apo tentativa për fshehje të pasurisë, dhe që - në sajë të peshës së tyre minimale dhe mungesës së pasojave - nuk mund të konsiderohen si deklarime të pamjaftueshme;
2. Kanë rezultuar mangësi të vogla të burimeve financiare, - për një total të akumuluar në tre vite (dhe të shpërndara në harkun kohor 9-vjeçar), në shumën prej 411.588 lekësh, të cilat, duke u çmuar nën dritën e parimit të proporcionalitetit, konsiderohen jo të mjaftueshme që të pasjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016;
3. Sa më lart rrjedh nga fakti që trupi gjykues vlerëson se, kur nga një analizë financiare që i referohet një segmenti kohor prej rreth dy dekadash, rezulton një mungesë financiare minimale, e shpërndarë ndër vite, ajo mund të tolerohet, jo vetëm për mundësinë e ndonjë pasaktësie në parametrat e përdorur përgjat procesit të përlllogaritjeve, por edhe në funksion, pikërisht, të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit, në bazë të të cilëve Komisioni çmon se nuk konstaton elementë të mjaftueshëm që të çojnë në aplikimin e masës së parashikuar në pikën 1/c të nenit 58 të

ligjit nr. 84/2016;

b- në lidhje me kontrollin e figurës:

1. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Peka, ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;
2. Nga analiza e të dhënave të parashikuara në pikën 1, neni 38, i ligjit nr. 84/2016, dhe kryesisht bazuar në raportin e DSIK-së, rezultoi që subjekti i rivlerësimit nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
3. Si rrjedhojë konkludohet se, subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Peka, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

c- në lidhje me vlerësimin e atësive profesionale:

Rezultoi se, pavarësisht vlerësimit pozitiv të Grupit të Punës së Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioni, ka konstatuar disa dyshime lidhur me aftësitë etiko - profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilat gjithsesi nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se, z. Dritan Peka, ka cenuar besimin e publikut, apo se ai nuk arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive të tij profesionale si prokuror;

Sigurisht që aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, si prokuror, nuk do të çenoheshin vetëm nga ndonjë pakujdesi organizuese apo neglijhencë e konstatuar në funksionin e drejtuesit, pasi në këtë rast do të mjaftonte largimi i tij nga funksioni i drejtuesit;

Por në rast se do të rezultonin të provuara dyshimet mbi favorizimet e qëllimshme, të sipërpërmendura - të aluduara lidhur me punësimin e z. A. M. dhe mbi pagesat e kryera në favor të tij në kundërshtim me ligjin - atëherë do të ishim përballë fakteve që tregojnë mangësi serioze etiko-profesionale, të cilat do të çonin në humbjen e besimit të publikut, dhe për rrjedhojë në aplikimin e nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

Për këto arsye, dhe për të mundësuar një qartësim të dyshimeve të ngrituara, trupi gjykues çmon që, në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, praktikën që lidhet me përzgjedhjen dhe punësimin e z. A. M., pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, si dhe në lidhje me kohëzgjatjen e lejes, me prezencën apo jo në vendin e punës dhe me pagesën e tij nga ky institucion, përgjatë periudhës korrik - tetor 2015.

Për rrjedhojë,

Trupi gjykues arrin në përfundimin se sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Peka:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;

3. ka arritur, së paku, një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, z. Dritan Peka, me funksion prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, të konfirmohet në detyrë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenet Ç, D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Peka, me funksion prokuror dhe drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Në zbatim të pikës 4 nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të transferojë pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, praktikën që lidhet me përzgjedhjen dhe punësimin e z. A. M., pranë Prokurorisë së Apelit Tiranë, si dhe në lidhje me kohëzgjatjen e lejes, prezencën apo jo të tij në vendin e punës dhe me pagesat e përfituara prej tij nga ky institucion, përgjatë periudhës korrik - tetor 2015.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 04.03.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Roland Ilia
Kryesues

Lulzim Hamitaj

Olsi Komici

Relator

Anëtar

*Sekretare gjyqësore
Anisa Duka*